REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

# RREGJISTRI I KËRKESAVE PËR INFORMACION

**Periudha Prill-Qershor 2024**

| **Nr rendor (1)** | **Data e kërkesës (2)** | **Objekti i kërkesës (3)** | **Data e përgjigjes (4)** | **Përgjigje (5)** | **Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)** | **Tarifa (7)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 15.04.2024 | 1. Sa është buxheti i parashikuar për artin dhe kulturën për vitet 2022-2023?<br>2. Sa nga ky buxhet është alokuar?<br>3. Kopje të listës së projekteve të financuara në art dhe kulturë nga institucioni për vitet 2022-2023 ku të përfshihen të dhëna lidhur me: titullin e projektit, vlerën e financuar, aplikanti përfitues, kohën e realizimit të projektit. | 24.04.2024 | Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 15.04.2024 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:<br>1. Sa është buxheti i parashikuar për artin dhe kulturën për vitet 2022-2023?<br>-Viti 2022-12'393'800 lek<br>-Viti 2023-26'470'200 lek<br>2. Sa nga ky buxhet është alokuar?<br>-Viti 2022- 28.9% e ralizimit<br>-Viti 2023-37.5% e realizimit<br>3. Kopje të listës së projekteve të financuara në art dhe kulturë nga institucioni për vitet 2022-2023 ku të përfshihen të dhëna lidhur me: titullin e projektit, vlerën e financuar, aplikanti përfitues, kohën e realizimit të projektit. | E përfunduar | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Viti 2022**<br><br>Pjesemarje ne Outdoor Festival Borsh - 2,000,000<br><br>Shpenzime ne kuader te aktivitetit te Javes Europiane -500,000<br><br>Pjesemarje ne Festivalin polifonik Netet e bejkes se Bardhe Pilur" -1,000,000<br><br>Takim brezash - 860,000<br><br>Dita e tokes (aktivitet per pastrimin e vijes bregdetare)- 200,000<br><br>Konkurisi i fjales artistike te shkollave-200,000<br><br>Kenget e Neco Mukes Himarioti - 800,000<br><br>Mbeshtetje financiare per promovimin e ISO-POLIFONISE - 1,193,400<br><br>Mbeshtetjefinanciare per festivalin Porto-Palermo - 600,000<br><br>Organizimi i Aktivitetit "Princesha mbi Bizele" - 300,000<br><br>Festa e femijeve 1 Qershori - 170,000<br><br>Aktivitetet dhe botimi i Antallogjise letrare - 500,000 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Festa e Fundvitit per Shkollat - 300,000<br><br>Festat e Pavarsise ( 110 vjetori) - 350,000<br><br>Fushate ne 14 ditet e aktivizmik kunder dhunes me baze gjinore - 200,000<br><br>Festa e Ullirit - 400,000<br><br>Aktivitet sensibilizues mbi autizmin - 100,000<br><br>Fushate Sensibilizuese per grate dhe vajzat (muaji Mars) - 150,000<br><br>Mbeshtetje financiare per eventin e Deliart Association - 800,000<br><br>Dokumentar per Artisten e popullit Hajrie Rondo - 700,000<br><br>**Viti 2023**<br><br>Pjesemarje ne Outdoor Festival Borsh 2,000,000<br><br>Shpenzime ne kuader te aktivitetit te Javes Europiane 600,000<br><br>Organizimi i simultanes se shahut Himare-Federata e shahut 500,000<br><br>Pjesemarje ne Festivalin polifonik Netet e bejkes se Bardhe Pilur" 1,500,000 | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Takim brezash 1,000,000<br><br>Dita e tokes (aktivitet per pastrimin e vijes bregdetare) 200,000<br><br>Konkurisi i fjales artistike te shkollave 500,000<br><br>Kenget e Neco Mukes Himarioti 1,000,000<br><br>Mbeshtetje financiare per festivalin Porto-Palermo 1,000,000<br><br>Festa e femijeve 1 Qershori 200,000<br><br>Aktivitetet dhe botimi i Antallogjise letrare 800,000<br><br>Festa e Fundvitit per Shkollat 500,000<br><br>Festa e Ullirit 500,000<br><br>Financim i projektit PINE per digjitalizimin e vlerave kulturore dhe artistike te bashkise 10,200,000<br><br>Aktivitet sensibilizues mbi autizmin 200,000<br><br>Fushate Sensibilizuese per grate dhe vajzat (muaji Mars) 200,000<br><br>Financim per "Internacional Music Festival" ne kalane e Himares 1,800,000 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Financim per "Sol International Music Festival" ne Vuno 1,800,000<br><br>PUNIME HIDROIZOLIMI NE QENDREN KULTURORE FTERRE 1,000,000 | | |
| 2. | 03.06.2024 | 1. Sezoni i plazhit ka filluar, por hyrja në Himarë ishte e vështirë për shkak të punimeve që po kryhen në qytet. Çfarë projektesh po realizohen?<br><br>2. Përse zhvillohen këto projekte në këtë kohë kur vështirëson akomodimin e turistëve nëpër hotele?<br><br>3. Cilat janë problematikat e identifikuara nga ju në këtë sezon turistik?<br><br>4. Çfarë masash ka marrë Bashkia për të qënë mikëpritës me turistët vendas dhe të huaj?<br><br>5. Sa turistë pritet të vijnë në Himarë? Si janë të dhënat krahasuar me një vit më parë?<br><br>6. A janë respektuar hapësirat e përcaktuara në ligj për plazhet publike? Sa përqind zënë dhe në cilat zona janë përcaktuar? | 05.06.2024 | Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 03.06.2024 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku<br><br>kërkohet "Kërkesë për informacion" pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi<br><br>pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:<br><br>1. Sezoni i plazhit ka filluar, por hyrja në Himarë ishte e vështirë për shkak të punimeve që<br><br>po kryhen në qytet. Çfarë projektesh po realizohen?<br><br>Projektet qe po realizohen jane si me poshte<br><br>"Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotur, sistemi i kanalizimeve, stacionet e pompimit, daljet në det Himarë dhe Orikum"<br><br>"Sistemi i furnizimit me ujë të Himarës, lidhja e linjës kryesore të dërgimit me sistemin e<br><br>furnizimit me ujë të fshatrave Pilur, Kudhës, Himarë fshat, dhe Vuno si dhe rrjeti i<br><br>brendshëm i ujësjellësit të këtyre fshatrave".<br><br>Për të përshpejtuar rehabilitimin e akseve kryesore infrastrukturore, planifikohen punime | E përfunduar | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | rrugore Fondi Shqiptar i Zhvillimit eshte financues dhe aplikues Bashkia Himare perfituese.<br><br>2. Përse zhvillohen këto projekte në këtë kohë kur vështirëson akomodimin e turistëve nëpër hotele?<br><br>Jane pune dhe procese te filluara me shume se nje vit me pare. Ne kuader te sezonit turistik bashkia ne komunikim me investitorin dhe zbatuesin, kane gjetur menyren me te mire te mundshme per te pershpejtuar mbylljen e punimeve ne pikat e fluksit. Dhe momentalisht mbi 85% e rrugeve jane te kryera.<br><br>3. Cilat janë problematikat e identifikuara nga ju në këtë sezon turistik?<br><br>Përgjithësisht sezoni turistik 2024 në Himarë po fillon i qetë dhe jo me ndonjë problematikë të dukshme.<br><br>Në Himarë problem i vetëm, të cilit i eshte dhënë tashme zgjidhje është rikonstruksioni i rrugëve kryesore dhe dytësore si pasojë e realizimit të projekteve te siperpermendura.<br><br>Fondi shqiptar i zhvillimit është financues dhe aplikues i dy projekteve :<br><br>4. Çfarë masash ka marrë Bashkia për të qënë mikëpritës me turistët vendas dhe të huaj?<br><br>Se pari jane marre masa per sigurine e plazheve:<br><br>- Vendosja e kufijeve per mjetet lundruese ne menyre qe te mos futen ne zonat ku lahen<br><br>turistet, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - Percaktimi dhe vendosja e korridoreve hyrese per mjetet lundruese<br><br>- Ndarja e kufijeve per stacionet e plazhit si edhe zbatimi I rregullores per rojet bregdetare<br><br>Se dyti argetimi dhe kulinaria:<br><br>- Mbeshtetja e disa eventeve me karakter artistik, kulturor dhe sportive (ketu permendim<br><br>South Outdoor Festival, Kala Fest, Bejk e Bardhe ne Pilur apo edhe evente qe do realizohen si Koncerti Olen Cezari, Panairi I Produkteve Artizanale, Traditat Kulinare Shqiptare, Panairi I Librit apo Liga e Lojrave te Aviacionit aktivitete të cilat i kemi mirëpritur dhe mbeshtetr me qëllim për të rritur vizitueshmerine dhe vizibilitetin per Himarën tone.<br><br>5. Sa turistë pritet të vijnë në Himarë? Si janë të dhënat krahasuar me një vit më parë?<br><br>Sipas parashikimeve qe ne kemi bere, ky vit pritet te kete nje rritje mesatarisht 30% deri ne 40% edhe pse pritshmerit tona jane per me teper ,duke futur dhe si faktor hapjen e tunelit te Llogarase. Duke iu referuar vitit te kaluar, shifrat flasin per nje rritje positive qe prej muajit Prill. Gjate ketij viti, muaji Prill pati nje rritje te ndjeshme (duke patur parasysh qe edhe koha ishte me e qendrueshme dhe njerzit paten mundesin te shijojne diellin dhe detin). Muaji Maj pati nje renie te lehte per shkake edhe te motit jo forte te mire por muaji Qershor tregon dukshem se ky sezon do te jete shume pozitiv per turizmin<br><br>ne bashkine tone. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 6. A janë respektuar hapësirat e përcaktuara në ligj për plazhet publike? Sa përqind zënë dhe në cilat zona janë përcaktuar?<br><br>Sikunder e permendem edhe me siper, Bashkia Himare ka mare te gjitha masat e nevojshme per te bere ndarjen e stacioneve te plazhit ku pjese e tyre jane edhe percaktimi I hapsirave publike. Sipas ligjit ne fuqi, hapsirat publike zene 30%. Thuajse te gjitha plazhet e Bashkise Himare kane hapsirat e tyre te dedikuara per publikun e gjere. Ne cdo plazh publik jane vendosur sinjalistika e nevojshme dhe monitorohen rregullisht per se siguruar mbarevajtjen e sezonit.<br><br>Ju falenderojme dhe ju presim ne Himaren tone te bukur dhe mikpritese, ju presim te<br><br>shijoni plazhet, ushqimin, malet dhe kulturen Himariote. | | |
| 3. | 15.05.2024 | 1.Cili është pronar i tokës numër 958 , Artileria Bregdetare Palasë?<br><br>2.Cili institucion është administrator i kësaj prone?<br><br>3.Cili është statusi i pronës me numër 958, Artileria Breggdetare, Palasë?<br><br>4. Aktualisht a po kryen punime në pronën numër 958 Artileria Breggdetare, Palasë nga operatorë privat?<br><br>5.Nëse po kryen punime cila është forma me të cilën kjo pronë ka kaluar tek privati dhe cili është roli | 27.05.2024 | Në bazë të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"dhe ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Referuar në kërkesën tuaj për informacion në lidhje me pronën Nr.958 "Artileria Bregdetare Palasë", ju bëjmë me dije se:<br><br>Në bazë të verifikimeve të kryera në arkivë-protokoll dhe në konsultë me "Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve" pranë Bashkia Himarë, me vendimin Nr.101, datë 20.02.2023 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore në Bashkinë Himarë", ende nuk është proceduar për vijimin e procedurës dhe përmbylljen e kalimit të pronësisë | E përfunduar | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | i bashkisë? A ka ndonjë kontratë qiraje, a është shitur apo është dhënë me koncesion?<br><br>6.A ka lidhur Bashkia Himarë në vitin 2022 kontratë me një subjekt privat në një pronë kufitare me pronën numër 958 Artileria Breggdetare, Palasë?<br><br>7.A jeni në dijeni që kjo kontratë e miratuar nga Bashkia Himarë të jetë përdorur nga kompania private për të hyrë në pronën numër 958 Artileria Breggdetare, Palasë? | | në emër të Bashkisë Himarë. Për objektin e kërkesës suaj gjendemi në pamundësi për tju vendosur në dispozicion një informacion më të detajuar në këtë kohë të shkurtër.<br><br>Ju faleminderit për mirëkuptimin! | | |
| 4. | 03.06.2024 | A ka pasur Bashkia juaj **buxhet vjetor** të **planifikuar për rininë** (grup moshën 15-<br>29 vjeç) për periudhën **janar - dhjetor 2023**? Nëse po, **sa përqind të shumës totale të buxhetit zënë këto zëra?** Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga **arsyet** përse nuk ka një planifikim të tillë?<br><br>2. Sa është **numri total i punonjësve** në<br>Bashkinë tuaj **(2023)**? Sa prej tyre janë **femra** dhe sa janë **meshkuj**? Sa prej tyre i përkasin **personave me aftësi të kufizuara**, edhe sipas **gjinisë**? | 11.06.2024 | 1.Bashkia Himare planifikon shpenzime dhe i realizon ato ne baze te buxhetit vjetor te saj, si dokumenti me i rendesishem strategjik qe shpreh vizionin per zhvillim dhe progres te Njesise Administrative. Duke u nisur nga pyetja juaj Nr 1, me togfjaleshin "Buxhet per rinine", po kuptoni grupmoshat 15 - 29 vjeçare. Ne kuptim te hartimit dhe zbatimit te buxhetit, nuk ka nje percaktim te qarte qe u drejtohet ketyre grupmoshave ne menyre specifike. Por megjithate ne konsiderate te pyetjes suaj, per vitin 2023 bashka ka hartuar buxhetin e saj dhe ne Programin Buxhetor "TRASHEGIMIA KULTURORE, EVENTE ARTISTIKE KULTURORE" mund e gjejme aktivitete te cilat mund ti perngjasojne | E përfunduar | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Sa është numri i të **rinjve** (18-29) **punonjës të bashkisë tuaj** në vitin **2023**? Sa prej t yre janë **femra** dhe sa janë **meshkuj**? Sa prej tyre i përkasin **personave me aftësi të kufizuara**, edhe sipas **gjinis ë**?<br><br>4. Sa është **numri i të rinjve** (18-29) **të punësuar** në bashkinë tuaj, të c ilët mbajnë **pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse?** (zv.kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre janë **femra** dhe sa ja në **meshkuj**? Sa prej tyre i përkasin **p ersonave me aftësi të kufizuara**, edhe si pas **gjinisë?**<br><br>5. A ka Bashkia juaj **politika rinore** të zh villura specifikisht për grup **moshën 15-29 vjeç**? Nëse jo, ju lutem a mund të na t regoni disa nga **arsyet** përse nuk ka të zh villuar një politikë të tillë?<br>6. A keni në institucionin tuaj, drejtori, se ktorë, **staf të dedikuar për rininë?** Prej s a kohësh janë funksionale?<br><br>7. A ka **struktura rinore të ngritura në Bashkinë** tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rin ore, parlament rinor, struktura konsultativ e rinore, etj.) për periudhën **janar - dhjet or 2023.** Nëse po, cilat janë ato?<br>8. Me kë keni **bashkëpunuar për ng ritjen e strukturave të tilla** (organiz ata rinore, grupe të rinjsh, individë, et j) | | pershkrimit tuaj. Per pjesen e eventeve artistike te cilat bashkia i financon, te tilla si festa e 1 qershorit, festa e 7-8 marsit, festa e fundvitit per shkollat dhe financime per evente te ndryshme artistikore si koncerte, South Outdoor festival, aktivitete per sportin dhe pjesemarrje ne aktivitete sportive, subvencine per klubin e sportit te te rinjve ato perbejne 6.8 % te totalit te shpenzimeve kapitale dhe operative te ketyre programeve buxhetore.<br><br>2. Numri total ishte 203, nga keta 71 femra dhe 132 meshkuj. Persona me aftesi te kufizuar 0.<br><br>3. Numri total ishte 30, nga keta 9 femra dhe 21 meshkuj. Persona me aftesi te kufizuar 0.<br><br>4. Numri total ishte 3, nga keta 1 femer dhe 2 meshkuj. Te 3 jane ne pozicionin pergjegjes sektori. Persona me aftesi te kufizuar 0.<br><br>5. Një nga politikat e ndjekura për aktivizimin e të rinjve të Bashkisë Himarë është<br><br>krijimi i Këshillit Rinor, që është specifiksiht aktiv për problematikat rinore, deri tani nuk kemi organizata të tjera rinore ose grupe vullnetare,kjo për shkak edhe të numrit të ulët që ka në territorin e Bashkis sonë.<br><br>6. Kemi nje punonjes te emeruar per rinine "Specialist i arsimit dhe rinise", ky pozicion eshte formuar ne vitin 2021.<br><br>7. -Ne kemi një person të dedikuar për çështjet e rinisë pranë bashkisë sone i cili eshte specialist i arsimit dhe rinise, pjese e drejtorisë së çështjeve sociale,arsimit dhe rinisë, structure | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 9. A keni një **plan veprimi për Këshillin Rinor Vendor (KVR)? Sa aktivitete** ja në organizuar nga KVR përgjatë 2023?<br><br>10. **Sa të rinj janë të përfshirë në KVR**? Sa prej tyre janë **femra** dhe sa ja në **meshkuj**? Sa prej tyre i përkasin **personave me aftësi të kufizuara**, edhe sipas **gjinisë**?<br>11. A keni pasur ju **forma të tjera bashkëpunimit** (me grupe të rinjsh, organizata rinore, etj) për zhvillimin e aktiviteteve me fokus rininë? Nëse po ku kanë konsistuar ato?<br><br>12. Sa është me përafërsi **pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike** të **zhvilluara nga bashkia? Cilat** janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese?<br><br>13. Lutemi listoni **mjetet e komunikimit** që përdor bashkia juaj dhe link përkatëse të faqes së **webit të bashkisë** (website) dhe rrjetet sociale si **Facebook dhe Instagram**.<br>14. Sa është **numri total i përfituesve** nga **Skema e Ndihmës Ekonomike** për vitin **2023?** Sa prej tyre janë **femra** dhe sa **meshkuj**?<br><br>15. Sa është **numri e të rinjve** (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e **Ndihmës Ekonomike** për vitin **2023**? Sa prej tyre janë **femra** dhe sa **meshkuj?** | | tjetër është Këshilli Vendor Rinor, momentalisht nuk ka një qëndër riore apo zyrë dedikuar vetëm rinisë.<br><br>8. -Bashkëpunimi jonë për çështjet e rinisë është kryesisht me të gjitha shkollat e Bashkisë sonë dhe më shumë me gjimnazet.<br><br>9. -Po kemi të parashikuar një sër aktivitetesh që janë për tu zhvilluar gjatë këtij viti, gjatë vitit 2023 nga KVR janë organizuar një anketë ndërgjegjësuese në të gjitha shkollat mbi përdorimin e paisjeve elektronike dhe varësin e të rinjve nga ato gjithashtu gjatë vitit 2023 ka qënë në plan për tu zhvilluar një shkëmbim rinor me Këshillin Rinor Tepelene por për disa problematika është shtyrë dhe presim ta zhvillojë së shpejti gjatë vitit 2024.<br><br>10. -Këshilli Rinor është i përbërë nga 5 anëtarë por jemi në pritje të emërimeve të tjera pasi kemi bërë thirrjen, janë 4 femra dhe një mashkull dhe nuk kemi asnjë person me aftësi të kufizuara.<br><br>11. -Po kemi pasur një bashkëpunim me organizatën Zëri i të rinjve në një trajnim dy ditor në një nga gjimnazet e Bashkisë Himarë që konsistoi në informin, argetim dhe ndërveprimin e të rinjve me njëri tjetrin, gjithashtu edhe bashkepunim me kordinatoren e Bashki të Forta. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 16. Sa është **numri total i përfituesve** të **Pagesës së Aftësisë së Kufizuar** për vitin **2023**? Sa prej tyre janë **femra** dhe sa **meshkuj?**<br><br>17. Sa është **numri e të rinjve** (15-29 vjeç) përfitues **të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar** për vitin **2023?** Sa prej tyre janë **femra** dhe sa **meshkuj**?<br><br>18. Sa është numri **total i personave** të cilat janë pjesë e **Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror** për vitin **2023**? Sa prej tyre janë **femra** dhe sa **meshkuj?**<br><br>19. Sa është numri i të **rinjve** (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë **e** Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2023? Sa prej tyre janë **femra** dhe sa **meshkuj** | | 12. Pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga Bashkia janë përafersisht rreth 20%. Disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese janw njoftimet qe publikohen te këndi i afishimeve pranë bashkisë si dhe rrejtet sociale.<br><br>13. Webi i bashkisw:https://himara.gov.al/<br><br>Emri facebook: Bashkia Himarw: https://www.facebook.com/bashkiahimare/?locale=sq_AL<br><br>14. Familje ne NE ne total 75 nga keto198 persona femra 108 meshkuj 90.<br><br>15. Mosha (15-29 )vjeç totali 48 persona nga keta femra 27 dhe meshkuj 21<br><br>16.Numri i personave me aftesi te kufizuar totali 280 nga keta femra 133 persona meshkuj 147 persona.<br><br>17.Numri total i te rinjeve (15-29) gjithsejt 27persona nga keta femra 16 dhe meshkuj 11.<br><br>18. Nuk kemi sherbime.<br><br>19. Nuk kemi sherbime. | | |

Shënim:

**1-Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve**
**2-Data e regjistrimit të kërkesë**
**3-Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi**
**4-Data e kthimit të përgjigjes**
**5-Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi**
**6-Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar**
**7-Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.**